



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

VENDIM
Nr. 597, datë 23.12.2021

PËR
NGRITJEN NË DETYRËN E GJYQTARIT TË GJYKATËS SË APELIT VLORË,
Z. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147, në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 3, të nenit 104, të Kodit të Procedurave Administrative, në shkronjën “ç”, të nenit 86 dhe nenet 97 e 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 10, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Vlorë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 545, datë 05.11.2020, mbi propozimin e relatores së procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve,

VENDOSI:

1. Ngritjen në detyrë të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Vlorë, z. {...}.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 17.01.2022.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Apelit Vlorë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR